



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 27 dt. 15.07.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.07.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin ”Nënë Tereza”, Tiranë me propozimet e mëposhtme:
 - Çlirimin dhe rehabilitimin e sheshit qendror nga shatërvani ekzistues.
 - Çlirimin dhe rehabilitimin e sheshit të kolonadave midis Rektoratit dhe Institutit të Arkeologjisë nga tenda e aktivitetit privat “Kolonat”.
 - Çlirimin nga kioskat, lokalet që ndodhen në të dy krahët e Universitetit Politeknik dhe rehabilitimin e këtyre zonave si hapësira të gjelbra.
 - Zbatimin e të gjitha ndërhyrjeve të tjera të parashikuara në projekt.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI